



LISTA E BORXHLINJVE NR. 11/2022 PËR BORXHE DERI MË 31.07,2022 DHE TË PAPAGUARA DERI MË 31.10.2022

Drejtoria e të Ardhurave Publike publikon Listën e borxhlinjve nr. 11/2022 për borxhe të vonuara 31.07/2022 dhe të papaguara deri më 31.10.2022 në bazë të TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimin personal i të ardhurave, kontributet e sigurimit të obligueshëm social, akciza dhe dogana, për të cilat shuma totale e borxhit është:

1. më e lartë për 120.000 denarë për personat fizik dhe kryerësit e veprimtarive të pavarur; dhe
2. më i lartë për 300.000 denarë për personat juridik.

Lista e borxhlinjve publikohet në web faqen e drejtorisë së të Ardhurave Publike në pajtim me Nenin 9 nga [Ligji për Procedurë tatimore](#).

Drejtoria e të Ardhurave Publike pa pajtim të obliguesit tatimor në web faqen e saj mund të publikon të dhëna për shkak të korigjimit të informatave jo të plota të cilat janë të publikuara në Listën e borxhlinjve.

Nëse obliguesi tatimor nuk pajtohet me të dhënat e publikuara, Ju lutemi të drejtoheni deri te:

- Drejtoria Regjionale përkatëse e DAP(shih kontakt) – për borxhet e publikuara në bazë të TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimin personal i të ardhurave dhe kontributet e sigurimit të obligueshëm social
- Drejtoria Doganore e RMV-së – Departamenti për pagesë të të ardhurave, buxhet, garante dhe analiza (tel. 02/3293 978 dhe 02/3293 971) – për borxhet e publikuara në bazë të akcizave, doganave dhe TVSH gjatë importit.

Në Listën e borxhlive nr.11/2022 janë publikuar 1.652 borxhli – persona juridik (12 më pak nga lista e mëparshme) dhe 3.209 persona fizik (21 më pak nga lista e mëparshme).

Neto borxhi total i publikuar në Listën nr.11/2022 është 7.889.882.213 denarë, 250.403.801 denarë më pak nga lista e mëparshme. Borxhi Neto për tatime dhe kontribute është 7.683.872.776 denarë, për 276.319.143 denarë më pak nga Lista e mëparshme), ndërsa borxhi për shpenzime doganore është 206.009.437 denarë (për 25.915.342 denarë më pak nga Lista e mëparshme).